

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E HENE 14 SHTATOR 2023

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sigurisht, me mirëkuptimin tuaj, nuk mund t'i rrimë dot strikt kësaj çështjeje të ditës dhe, sigurisht, është një hap pozitiv, por për sa i takon peshës që ka, është kaq i kufizuar sa që komentet e gjata nuk i meriton, pasi të vërtetat dhe hallet e mëdha të këtij vendi janë shumë më të rënda se kaq. Megjithatë, për të qenë të qartë lidhur me ato që po e zhbëjnë këtë vend, është mirë t'ju citoj disa fjalë të ish-Kryeministres së Izraelit, të madhes Golda Mejer. Kjo është përgjigje për të gjithë propagandën, për të gjithë mashtrimet dhe hipokrizinë e tmerrshme të qeverisë dhe të deputetëve në këtë sallë, lidhur me një çështje të madhe, që ka të bëjë me ekzistencën e vet kombit. Ajo thotë: "Nëse doni të ndërtoni një vend, ku do të kthehen djemtë dhe vajzat e tij, nëse doni të ndërtoni një vend, që njerëzit do të largohen vetëm për festa dhe ku nuk do të ketë frikë për të ardhmen, atëherë, duhet të bëni vetëm 3 hapa: së pari, barazoni korrupsionin me tradhtinë ndaj atdheut dhe zyrtarët e korruptuar me tradhtarët deri në brezin e 7-të; së dyti, bëjini mësuesit dhe mjekët profesionet më të paguara dhe më prestigjioze dhe, së treti, dhe më e rëndësishmja, punë, punë dhe vetëm punë, sepse askush tjetër përveç teje nuk do të të mbrojë, askush nuk do të të ushqejë, përveç vetes, dhe vendi yt të nevojitet vetëm ty dhe askujt tjetër. Kur kjo të bëhet jo vetëm një fjalë dhe slogan, por një mënyrë jetese, do të thotë se keni arritur qëllimin tuaj". Pra, sinteza është shumë e qartë, ndërkohë që dëgjoni këto fjalë, trinomi: grabitje, kreditë sklavëruese, që janë borxhe, dhe shpopullimi, është një trinomi, i cili po zhbën në çdo minutë dhe çdo sekondë vendin. Ky trinomi i mbështetur në një bazë tjetër, e cila ka tri kolona: korrupsionin, trafikun masiv të të gjitha llojeve, drogën, mbi të gjitha, dhe pastrimin e parave, janë, sigurisht, dy treshat e mëdhenj, të cilët e kanë kapur për fyti këtë vend dhe kanë bërë që të shpopullohet.

Është e tmerrshme të mendosh që ky institucion, i cili, për definicion dhe për mision, duhet të ishte barriera e këtij korrupsioni, barriera e këtij abuzimi shtetëror, barriera, e cila, në emër të zërit të njerëzve që përfaqëson, do ta bënte këtë funksion mburoje, është thjesht dhe vetëm betonuesi, lehtësuesi dhe mundësuesi, njëkohësisht edhe krijimi i të gjithë mekanizmit mbrojtës të këtij korrupsioni, duke krijuar atë të ashtuquajturën 'përgjegjësi kolektive', për të shmangur sa më shumë të jetë e mundur përgjegjësinë individuale dhe për t'i dhënë mundësi korrupsionit të ecë me galop. Sigurisht që shifrat janë kokëforta. Këtu u fol shumë për pensionet dhe bëhet shumë mirë që flitet për to, por është shumë mirë që të themi të vërtetat. Është e qartë që skemës së pensioneve, sipas vetë atyre që e operojnë, i rri te pragu i derës rreziku i falimentimit. Kjo është shumë e qartë, sepse kontribuuesit vetëm pakësohen, mesatarja e pensionit në qytet (jo sipas meje, por sipas shifrave zyrtare) është një mesatare nën minimumin e varfërisë relative, sipas Bankës Botërore, në masën 85-90% të tyre, po kështu është edhe në fshat, që është, sigurisht, nën këtë minimum varfërie, ku mesatarja nuk është as 100 dollarë, ndërkohë që mesatarja në ditë e varfërisë është 6,8 dollarë. Çfarë propagande bëjmë me pensionet?! Është mirë që për pensionet të mos flasim fare, (të bëjnë të gjitha sakrificat, faktet flasin vetë) dhe të mos vazhdojnë të gënjejnë e të duartrokasin në mënyrë të turpshme, ndërkohë që varfëria është te pragu i derës. Kjo varfëri bën që mijëra pensionistë t'i blejnë barnat me tableta dhe jo me kurën e plotë që mbulon terapinë e tyre, duke ngushëlluar veten me iluzionin johuman, por është i imponuar për varfërinë e tyre, që të mos marrin terapinë në mënyrë të përditshme, por t'i marrin ilaçet një herë në dy apo tri ditë. Shkoni në një farmaci dhe shikoni (nuk më thotë dot njeri, edhe nga këta të thekurit e partisë në pushtet) se, përpara se t'ju japin barnat, ata i hapin kutitë të shohin nëse janë të plotë apo jo, pasi një pjesë e tyre shiten me tableta.

Kjo është një gjë e frikshme dhe e padëgjuar, sepse kemi të bëjmë me shëndetin e njerëzve, e mira themelore, të gjitha të tjerat bëhen të mira relative. Kjo situatë dramatike ka bërë që vetëm në 6 muajt e parë të kemi 16 500 kërkesa për azil, pa llogaritur shumë të tjerë informalë, të cilët nuk marrin kontakte me autoritetet në vendet ku ikin. Me 16500-17000 banorë, të nderuar kolegë, ju e dini shumë mirë që mund të jenë mbi 20 bashki në territorin e Shqipërisë, të cilat kanë një popullsi të barabartë me kaq, më të vogël apo pak më të lartë se kaq. Pra, na zhduket një bashki në vit. Çfarë propagande bëni ju, nuk e kuptoj?! Si mund të ekzistojë një pacipësi kaq e madhe?! Këto shifra nuk janë tonat, sepse shifrat e opozitës janë gjithmonë një turp, një herezi, një faj, por shifrat janë të Evropës, që i ka regjistruar. Pra, brenda 6 muajsh zhduket një bashki dhe ju flisni për suksese, thoni: “Çfarë bëmë dhe si e gjetëm”, por, meqenëse përmendni sesi e gjetët dhe sesi e bëtë, po ju jap një shembull, meqenëse e keni memorien të shpartalluar qëllimisht. Në vitet 2011-2012 IOM-i, Organizata Ndërkombëtare e Emigracionit, ngriti një program për rikthimet në Shqipëri. Por kur ndodhën rikthimet?! Ndërkohë ishin liberalizuar vizat dhe nga liberalizimi i vizave, në teori, siç thoshit ju kur ishit në opozitë, do të iknin 1 milion shqiptarë, por nuk ndodhi, ndodhi e kundërta dhe u bë projekt më vete. Ju bëni sikur harroni, sepse mbani mend vetëm turpet që bëni andej, por përpara vitit 2013, me misionin që Sesilia Malstrom, komisarë për çështjet e brendshme të Bashkimit Europian, bëri në Tiranë, erdhi dhe promovoi Shqipërinë si histori suksesi dhe si problem shumë të madh Serbinë dhe Maqedoninë, për largimet masive nga vendi. Pra, meqenëse e keni për zemër historinë se si ishim dhe ku jemi, kjo ishte histori suksesi, i cili ishte program për t'i kthyer njerëzit, ndërsa sot kemi batërdi ikjeje. Të ikësh nga vendi, nuk ikën nga lumturia, por ikën thjesht dhe vetëm nga halli; ikën, sepse nuk ke ku të fusësh kokën, nuk ke si të strehohesh, pasi të strehohesh duhet të kesh kushte lehtësuese dhe ndihmë për qytetarët.

Cila është ndihma që u jepet qytetarëve? Rriten çmimet e referencës, rriten të gjitha llojet e taksave, që rëndojnë mbi banesën dhe rritet çmimi i tyre. Pra, çfarë bëhet me mundësinë e strehimit, me themelin e jetës, sepse themeli i saj banesa është?! Bëhet një pamundësi absolute. Ishte një pamundësi shumë e madhe për të blerë një banesë, sepse duheshin 20 e kusur vjet për të pasur një banesë dhe, në vend që të mendosh se si t'i lehtësojmë, që këto çmime banesash të bien dhe të jenë të arritshme për qytetarët, ato aq më keq rriten. Pse ndodh kjo? Sepse, në qoftë se qeveria do të bëjë ndonjë rritje pagash apo pensionesh, të gjithë këtë do t'u hedhë qytetarëve në kokë. Pra, duke ua shtuar taksat, duke ua shtuar të tjerat, në të gjitha rastet e pësojnë ata, por gjoksin këtu e rreh qeveria, duke thënë: “Qeveria i rriti”, pra, me atë iluzionin që lekët janë të tyret, por harrojnë që lekët mbledhen nga këto qindra e mijëra kontribute, djersë, sakrificat dhe plot e plot gjëra të tjera. Çfarë ndodh nga e gjithë kjo? Nuk ekziston asnjë element që mundëson që shqiptarët të rrinë këtu. Kjo ndodh sepse mungojnë ato tri shtyllat, që ish-kryeministrja e Izraelit thoshte: “Në raste korrupsioni të korruptuarit të barazohen me tradhtarët, deri në 7 breza...”, pra, korrupsioni të trajtohet si kanceri që ha këtë vend. Ai justifikohet me kumbullat që hahen prapa kurrizit, kumbullat duhet të hahen, por jo pa leje dhe pas kurrizit dhe të zëvendësohen palë-palë hajdutët me hajdutë të tjerë. Prandaj ky vend nuk mund të bëjë hajër. Dëshpërimi dhe drama e zhbërjes së këtij vendi i qëndron si shpata e Demokleut, Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Faleminderit!